

VENDIM
Nr. 314, datë 6.12.2022

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS NR. 395,
SERIA F18 TË SHOQËRISË “ENERGJI ASHTA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE,**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 16, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, i ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2026 prot., datë 2.12.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Energji Ashta” sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1841/1 prot., datë 24.11.2022, ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për rinovimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e kërkuar nga neni 16 “Rinovimi i licencës”; formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1 (neni 16, germa “a”); çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë (neni 16, germa “b”); informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur) (neni 16, germa “c”) shtojca 1.I; të ketë kryer pagesën e aplikimit dhe atë të rregullimit në ERE (neni 16, pika 7).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar. Po ashtu shoqëria nuk rezulton debitore e pagesave të rregullimit ndaj ERE-s.

- Nga aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Energji Ashta” sh.a. rezulton se është pa plotësuar sa vijon:

Neni 16, pika 1, gjerat “b” dhe “c” (shtojca 1.I)

- **Germa “b”, pa plotësuar.**

Shoqëria duhet të na informojë nëse ka pësuar ndryshime apo modifikime të mundshme të dokumentacionit të të dhënave teknike të depozituar në aplikimin për licencë.

- **Germa “c”, plotësuar pjesërisht.**

Duke qenë se shoqëria nuk ka përcjellë informacion, dhe sa rezulton nga të dhënat që ERE disponon, nuk e ka ushtruar veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, në vijim do t’i kërkohej të përcjelli këtë deklaratë në ERE.

- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet shoqëria që ta përcjellë brenda afateve të përcaktuara nga ERE.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 395, seria F18, të shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti